

RAPORT

i Komisionit vlerësues për ndarjen e “Shpërblimit mbështetës 2014” për rezultate të rëndësishme, të veçanta, në fushën e shkencës dhe të artit të kandidatëve të moshës së re



Komisioni Vlerësues për ndarjen e “Shpërblimit mbështetës 2014”, i themeluar nga Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, pasi vlerësoi dokumentacionin e katër kandidatëve të paraqitur në Konkursin e shpallur në shtypin e përditshëm dhe në faqen e internetit të ASHAK-ut, vendosi njëzëri që «Shpërblimi mbështetës 2014» t’i takojë dr. Qëndrim Gashit, profesor i asocuar në Departamentin e Matematikës të FSHMN-së të UP-s

Dr. Qëndrim Gashi u lind më 4 qershor 1984 në Prishtinë. Talenti i tij u vërejt që në vitet e para të shkollimit, kur ai zuri vendin e parë në Olimpiadën Matematike në Shtimje, në vitin 1997 dhe të njëjtin vit, vendin e parë në Olimpiadën gjithëkombëtare të Matematikës të revistës “Plus” në Kërçovë të Maqedonisë.

Si nxënës me prirje dhe aftësi të veçanta për matematikë, Q. Gashi pas kryerjes së shkollës fillore, me lejen e organeve kompetente, më 1998 regjistron studimet në Departamentin e Matematikës të FSHMN-së të Universitetit të Prishtinës. Ishte ky një rast i veçantë dhe i rrallë jo vetëm në vendin tonë. Me punën e zellshme dhe talentin e rrallë, Q. Gashi i përfundon studimet me sukses të shkëlqyeshëm në afat rekord në vitin 2002.

Studimet pasuniversitare i kryen në qendrat më të njohura botërore. Kështu, në vitin 2003 fiton gradën M.A.St.(Master of Advanced Studies) në Matematikë në Universitetin e Kembrixhit (Angli), për të vazhduar më tej në Universitetin e Çikagos (SHBA) ku në vitin 2003 merr gradë M.S. (Master of Sciences). Në Universitetin e Çikagos i vazhdon edhe studimet e doktoraturës, të cilat i përfundon në vitin 2008. Më 19 shkurt 2008, në moshën 23 vjeçare, e mbron me sukses temën e doktoratës me titull “The Conjecture of Kottwitz and Rapoport in the case of split groups” nën udhëheqjen e profesorit dhe matematikanit amerikan me famë botërore Kottëicz dhe, kështu, bëhet doktori më i ri i shkencave matematike (fiton gradën Ph.d. në Matematikë).

Punën e tij shkencore dr. Qëndrim Gashi e vazhdon duke bashkëpunuar me matematikanë bashkëkohorë të njohur ndërkombëtarisht dhe duke botuar punimet e tij shkencore në revistat

më prestigjioze botërore të matematikës, siç janë “Annales Scientifiques de l’Ecole Normale Supérieure”, “Journal of Algebraic Combinatorics”, “Journal of Combinatorial Theory-Series A”, etj. Deri më tash dr. Q. Gashi ka botuar dhe i ka përgatitur një varg punimesh shkencore.

Në vazhdim po e japim një analizë të shkurtër të disa punimeve kryesore të prof. dr. Q. Gashit.

Në punimin *On a Conjecture of Kottwitz and Rapoport* zgjidhet një problem i propozuar nga matematikanët Kottwitz dhe Rapoport me ç’rast gjendet kushti i nevojshëm dhe i mjaftueshëm që një varietete afine e Deigne-Lusztigut (VADL) të jetë joboshe. Ky problem është i njohur edhe me emrin “e anasjellta e pabarazimit të B. Mazurit” dhe ai është zgjidhur duke zbatuar teknika nga kombinatorika algjebrike- më saktësisht, një version të ashtuquajturës lojë e numrave e S. Mozes. Për shtjellimin e këtij punimi kërkohen njohuri të thella nga disiplina të ndryshme matematike siç janë gjeometria algjebrike, teoria e numrave, teoria e përfaqësimeve, etj. Për rëndësinë e këtij punimi më së miri flet citimi i tij në punimet e një numri të konsiderueshëm autorësh si p.sh. U. Goertz, T. Haines, U. Hartl, R. Kottwitz, E. Viehman dhe, mbi të gjithë, S. Smirnov (fituesi i Medaljes “Fields” që për matematikanët është e barasvlershme me çmimin “Nobel”).

Në punimin *On dominance and minuscule Weyl group elements*, Q. Gashi në bashkautorësi me T. Schedler studiojnë kuptimin e dominancës në sistemet e rrënjëve dhe lidhjen e tyre me elementet “e vogla” të grupit të Weylit. Në këtë punim, më tej, studiohet në detaje e ashtuquajtura lojë e numrave me prerje, e zbuluar për herë të parë nga Q. Gashi në punimin 1. të analizuar më sipër. Këtu studiohet dhe zgjidhet një version më i gjerë i këtij problemi.

Looping of the numbers game and the alcoved hypercube është një punim në të cilin studiohen orbitat e fundme të përfaqësimeve reflektive të grupeve afine të Weylit që gjenden në kufirin e konit të Tits-it. Një ndër rezultatet e këtij punimi është edhe copëzimi i grupit të fundmë të Weylit në bashkësi pjesërisht të renditura të graduara. Për dallim nga renditjet e dobëta të Bruhatit, shkalla më e madhe është kubike, që është një rezultat mjaft befasues.

Në punimin *Projective normality of toric varieties arising from root systems* studiohen varietetet torike që dalin nga sistemet e rrënjëve ku shqyrtohet hipoteza e Odas e cila zgjidhet për rastet e ndarësve specialë.

Veprimtaria shkencore e prof. Qëndrim Gashit dëshmohej edhe me pjesëmarrjen aktive dhe impulsive të tij në seminare, konferenca dhe tubime të ndryshme shkencore, anë e kënd botës. Po i përmendim disa prej tyre: Në Universitetin e Edinburgut (shtator 2013); në Universitetin e Kuinslendit, Brisbane (gusht 2013); në Universitetin e Oaklandit (maj 2012); Hausdorff Institute of Mathematics, Bonn (prill 2010); Max-Planck-Institut für Mathematik, Bonn (qershor 2009); MIT (prill 2009); Universitetin e Çikagos (prill, 2009); University of British Columbia, Vancouver (mars-prill 2009); në Universitetin e Gjenevës (mars 2009), në Universitetin e Bonnit (nëntor 2008); në Institute de Mathematics de Jussieu, Paris (maj 2008); në Purdue University (janar 2007); në Universitetin e Oakland-it (shtator 2006) dhe në Stanford University (qershor 2006).

Një veprimtari kaq e begatë dhe e bujshme shkencore e profesor Gashit nuk mbetet pa u vlerësua nga institucione të rëndësishme të botës shkencore. Ai është fitues i merituar i një numri të konsiderueshëm të bursave dhe çmimeve prestigjioze. Po i theksojmë disa prej tyre: NANUM Ambasador 2014, Kongresi Ndërkombëtar i Matematikanëve; Shkencëtar i Ri i Vitit, Kosovë 2012; Fellow i European Post-Doctoral Institute, 2008-2010; Clay Mathematics Institute Lifford

Fellowship, 2008; Çmimi Carlos Isnard Ph.D. Graduate Mathematics Studies Memorial, Universiteti i Çikagos, 2007; Çmimi për mësimdhënie Lawrence and Josephine Graves (Universiteti i Çikagos), 2007; Dy grante nga KFOS, 2002-2003 dhe 2003-2004; Trinity College (University of Cambridge) Eastern European Bursary, 2002-2003; Honory Student, Cambridge Overseas Trust, 2002-2003; Student i dalluar, Universiteti i Prishtinës, 2002.

Ndonëse në moshë të ri, dr. Qëndrim Gashi, përveç punës së tij të frytshme shkencore, e cila e nderon jo vetëm atë por edhe gjithë komunitetin tonë shkencor, ka edhe një karrierë të admirueshme universitare e profesionale. Si student të doktoraturës në Universitetin e Çikagos, atë e gjejmë edhe mësimdhënës në nivelin bachelor në këtë universitet (2005-2008). Veprimtarinë e tij pedagogjike shkencore e zhvillon edhe në Institutin Max-Plank për Matematikë në Bon (Gjermani, shtator 2008-korrik 2009); në Institutin Isak Njuton për Shkencat Matematike në Kembrixh (Angli, korrik-dhjetor 2009); në Institut des Hautes Études Scientifiques, (Bures-sur-Yvette, Francë, janar-gusht, 2010), për të vazhduar si Profesor i asocuar në Departamentin e Matematikës të FSHMN-së të Universitetit të Prishtinës (2010 e në vazhdim).

Përkundër këtij angazhimi të bujshëm shkencor dhe profesional, profesor Qëndrim Gashi gjen kohë edhe për angazhime tjera vullnetare në rrafshin profesional. Ai është themelues i Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës në vitin 2008 (kryetar i së cilës ka qenë në dy mandate dyvjeçare) dhe më meritori për anëtarësimin e saj në Shoqatën e Matematikanëve të Europës; nismëtar i mbajtjes së Olimpiadës Matematike të Kosovës (OMK) dhe kryekoordinator i saj për tri vite radhazi (2009-2012). Meritë e dr. Q. Gashit është anëtarësimi i OMK-së si anëtare me të drejta të plota në Olimpiadën Ndërkombëtare të Matematikës (IMO) ku Ekipi i Kosovës merr pjesë tri vite me radhë. Është udhëheqës i klubit AniMat të matematikanëve të rinj. Gjatë qëndrimit studimor në Universitetin e Çikagos, dr. Q. Gashi ishte edhe Instruktor i nxënësve në Hyde Park (2004-2006), anëtar i Komisionit Directed Reading Program (2005-2007) si dhe organizator i Seminarit Graduate Student “Pizza” (2004-2005). Janë këto aktivitete të cilat, padyshim, kanë ndikuar në ngritjen e cilësisë së matematikës dhe në motivimin dhe nxitjen e të rinjve për të studiuar matematikën.

Edhe pse i ri në moshë (së shpejti do t’i mbushë 30 vjet), Dr. Qëndrim Gashi, pa dyshim, është një punëtor i mirëfilltë shkencor. Me aktivitetin i tij shkencor e profesional ai e afirmoi shkencën tonë në mënyrën më të denjë në suaza ndërkombëtare. Jemi thellë të bindur që ai e meriton “Shpërblimin mbështetës 2014” që ASHAK-u e ndan për shkencëtarin më të ri dhe më të suksesshëm. Prandaj, me kënaqësi e propozojmë që ky shpërblim t’i ndahet dr. Qëndrim Gashit, profesor i asocuar, si mirënjohje për kontributin shkencor dhe si një shtytje për punën e tij të mëtejme shkencore dhe profesionale.

Në Prishtinë, më 10 shkurt 2014.

Anëtarët e Komisionit:

1. Akademik Hivzi Islami
2. Akademik Tahir Emra
3. Anëtari korresp. Qamil Haxhibeqiri